

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.872/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm- Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri në çështjen penale kundër të pandehurit P.M nga ... rr. "...", për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-se, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.206/2013 të datës 18.10.2018, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 15.02.2019, në të njëjtën datë, në mungesë të prokurores Jagodinka Nikoliq, në prezencë të të pandehurit P.M, ka shpallur publikisht, ndërsa me 12.03.2019 përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: P.M , nga i ati F. e ëma N., e vajzërisë A., i lindur me ..., me nr. Personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion mekanik, Shqiptar , Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me 07.10.2011 rreth orës 14:20 në ... në shtëpinë familjare të të dëmtuarit A.I, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për arme nr. 03-L/143 ka kanosur të dëmtuarin A.I në atë mënyrë që ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit duke mbajtur arme dhe atë pushkën automatike tip M70 AB2-Kallash të kalibrit 7.62x 39mm me numrin serik 360525 dhe ka kanosur nënën e të pandehurit N.I se do të vriste djemtë dhe bashkëshortin dhe pastaj ka dalë duke mbajtur arme duke vazhduar në drejtim të pompës së derivateve "... " në rr. "...", por disa persona e kanë ndaluar dhe rastrin kanë paraqitur në polici..

Me këtë ka kryer veprën penale- **Mbajtja në pronësi kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 KPK-se**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 3,11,35,39,64, dhe 328 me par. 1 të KPK-ës dhe nenit 365, 450,463 të KPP-ës i:

G J Y K O N

DENIM MË GJOBË në shume prej 1000€ (njëmijë euro), të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim do t'i zëvendësohet në bazë të nenit 39 parag.4 të KPK-së.

Ne mbështetje të nenit 328 par.5 e lidhur me nenin 60 të KPK-së dhe nenin 282 par.2 nenpar.2.1 të KPP-se, të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskimi i sendeve dhe atë:

Një PUSHK AK/47 M.70.AB 2 me nr. serik. 360525.

Urdhërohet Policia e Kosovës që pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, sendet e konfiskuar t'i shkatërroj.

OBLIGOHET i pandehuri që ne emër të shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto është i obliguar që të paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuze PP.nr.206/2013 të datës 18.10.2018 kundër të pandehurit P.M, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-se.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 15.02.2019 ashtu që në këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë për veprën penale që më vihet në barë, këtë e bëj me vullnet dhe pa presionin e askujt.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja deklaron se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë ngase i njëjti ishte në përputhje të plot me faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe njëherit i propozon gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta dënoj sipas ligjit dhe të marrë parasysh rrethanat rëndues dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. F.V lidhur me pranimin e fajësisë deklaron: e mbështes në tersi deklarinimin e klientit tim për pranimin e fajësisë i cili është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme e duke sqaruar dhe bënifitet e pranimit të fajësisë që i njëjti ka pranuar fajësinë lusim gjykatën që më rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit të shqiptoj një dënim sa më të but duke pasur parasysh se ka qenë i moshës së re kur është kryer vepra penale dhe nga ajo kohë nuk ka bërë asnjë veprë penale është pënduar thëllë i premtos gjykatës se kurrë nuk do të shë në këtë situatë që të kryej ndonjë veprë tjetër penale, pasi që klienti i imë tani është bërë prind ka krijuar familje e ndjen veten shumë fajtor për rastin që ka ndodhur, po ashtu edhe më fqijun tani i kanë raportet e mira.

II. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bënë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, e

qe konkretisht i pandehuri ka përdorë ne mënyrë te paautorizuar arme-pushkë automatike e tip M70 AB2-Kallash te kal. 7.62x 39mm, me numër serik 360525, ku me te njëjtën ka shkuar ne shtëpinë e A.I dhe ka kanosur nënën e te dëmtuarit se do ti vriste djemtë dhe bashkëshortin e saj dhe ka dal duke e mbajtur armen duke vazhduar ne drejtim te pompës se derivateve “...” ne rr. “...”, kështu qe e njëjta arme konfiskohet si prove materiale, për shkak se i dyshuari nuk posedon leje valide për te dhe e njëjta është përfshirë ne rastin për kanosje, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat.

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme me dënim me burgim prej 1 deri ne 10 vite, ose dënim me gjobe deri ne 10.000 vite, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykate si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale qe rezulton se i pandehuri ditën kritike kishte përdorur armen te paautorizuar, ne rastin konkret i pandehuri kishte rrezikuar jetën e personave prezent.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, se qe nga kryerja e kësaj vepre penale ka kaluar një kohe e gjatë, i njëjti është mbajtës i familjes, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimin te fajësisë rezulton se ai edhe vet deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënimin i shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi qe do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat ligjore lidhur me shqiptimin e dënimit plotësues, ashtu qe ne baze te dispozitës 328 par 5 ne lidhje me nenin 60 te KPK-se, ku përcaktohet se armët qe perdoren apo mbahen ne kundërshtim ne rrethana dhe kushtet per lejen e armës te njëjtat konfiskohen, e nen këto rrethana gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimin shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil .

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.872/2018 dt.12.03.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, e nëpërmes kësaj gjykate.